

REPORT DOCUMENTATION PAGE			Form Approved OMB No. 0704-0188	
Public reporting burden for this collection of information is estimated to average 1 hour per response, including the time for reviewing instructions, searching existing data sources, gathering and maintaining the data needed, and completing and reviewing the collection of information. Send comments regarding this burden estimate or any other aspect of this collection of information, including suggestions for reducing this burden, to Washington Headquarters Services, Directorate for Information Operations and Reports, 1215 Jefferson Davis Highway, Suite 1204, Arlington, VA 22202-4302, and to the Office of Management and Budget, Paperwork Reduction Project (0704-0188), Washington, DC 20503.				
1. AGENCY USE ONLY (Leave Blank)	2. REPORT DATE September 1995	3. REPORT TYPE AND DATES COVERED Final		
4. TITLE AND SUBTITLE Glossary of Commercial and Trade Law Terms/Fjalorthi i Termave të Ligjit Tregtar: English/Albanian -- Albanian/English			5. FUNDING NUMBERS	
6. AUTHOR(S) Helen Fedor				
7. PERFORMING ORGANIZATION NAME(S) AND ADDRESS(ES) Federal Research Division Library of Congress Washington, DC 20540-4840			8. PERFORMING ORGANIZATION REPORT NUMBER	
9. SPONSORING/MONITORING AGENCY NAME(S) AND ADDRESS(ES) N/A			10. SPONSORING/MONITORING AGENCY REPORT NUMBER	
11. SUPPLEMENTARY NOTES Prepared under an Interagency Agreement				
12a. DISTRIBUTION/AVAILABILITY STATEMENT Approved for public release; distribution unlimited.			12b. DISTRIBUTION CODE	
13. ABSTRACT (Maximum 200 words) The definitions provided in this bilingual glossary are intended to serve as indicative explanations of the defined words and phrases, and not for purposes of interpreting any particular contract or international agreement. Approximately 100 terms appear with English and Albanian definitions.				
14. SUBJECT TERMS Albania Law Commercial and trade terms			15. NUMBER OF PAGES 33	
			16. PRICE CODE	
17. SECURITY CLASSIFICATION OF REPORT UNCLASSIFIED	18. SECURITY CLASSIFICATION OF THIS PAGE UNCLASSIFIED	19. SECURITY CLASSIFICATION OF ABSTRACT UNCLASSIFIED	20. LIMITATION OF ABSTRACT SAR	



**GLOSSARY OF
COMMERCIAL AND TRADE LAW TERMS**

FJALORTHË I TERMAVE TË LIGJIT TREGTAR

**ENGLISH/ALBANIAN
ALBANIAN/ENGLISH**

*A Report Prepared under an Interagency Agreement
by the Federal Research Division,
Library of Congress*

September 1995

19960408 050

Project Manager: Helen Fedor


*Federal Research Division
Library of Congress
Washington, DC 20540-4840*

Dear Reader:

This product was prepared by the staff of the *Federal Research Division* of the *Library of Congress* under an interagency agreement with the sponsoring United States Government agency.

The Federal Research Division is the Library of Congress's primary fee-for-service research unit. At the request of Executive and Judicial branch agencies of the United States Government and on a cost-recovery basis, the Division prepares studies and reports, chronologies, bibliographies, foreign-language abstracts, databases, and other tailored products in hard-copy and electronic media. The subjects researched include the broad spectrum of social sciences, physical sciences, and the humanities.

For additional information on obtaining the research and analytical services of the Federal Research Division, please call 202-707-9905, fax 202-707-9920, via Internet frd@mail.loc.gov, or write to *Marketing Coordinator, Federal Research Division, Library of Congress, Washington, DC 20540-4840*.



Louis R. Mortimer
Chief

Federal Research Division
Library of Congress
Washington, DC 20540-4840

GLOSSARY OF
COMMERCIAL AND TRADE LAW TERMS

FJALORTHË I TERMAVE TË LIGJIT TREGTAR

ENGLISH/ALBANIAN
ALBANIAN/ENGLISH

The definitions provided herein are intended to serve as indicative explanations of the defined words and phrases, and should not be used for purposes of interpreting any particular contract or international agreement.

These definitions are not intended to express, and may not reflect, official Department of Commerce or U.S. Government interpretation of the defined words or phrases.

Përcaktimet e përfshira në këtë fjalorth kanë për qëllim të shërbejnë si shpjegime indikative të fjalëve dhe frazave të përcaktuara, dhe nuk duhet të synohet të përdoret për interpretimin e ndonjë kontrate të veçantë ose të ndonjë marrëveshjeje ndërkombëtare.

Këto përcaktime nuk kanë për qëllim të shprehin, dhe as të pasqyrojnë, interpretimet zyrtare të ndonjë fjale ose fraze të përcaktuar nga Departamenti i Tregtisë ose nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara.

COMMERCIAL LAW DEVELOPMENT PROGRAM

The Commercial Law Development Program (CLDP), a Department of Commerce initiative funded in part by the Agency for International Development, is one component of the U.S. Government effort to support the economic and political reforms underway around the globe. CLDP provides training and consultative services to lawmakers, regulators, judges, lawyers, and educators seeking assistance in the evaluation, revision, and implementation of evolving legal systems.

CLDP law development assistance programs typically focus on laws, regulations, and administrative practices affecting domestic and foreign investment and trade, particularly international economic agreements, foreign investment laws, project and trade finance, export controls, intellectual property rights, and government ethics.

CLDP professional skills development assistance focuses on building the knowledge base and practical skills needed to effectively utilize these evolving legal structures and to bring new participants and new ideas into the commercial marketplace.

Most CLDP activities are part of comprehensive assistance programs focussed on various aspects of one or two issues of interest to a host government, rather than *ad hoc* efforts. Programs typically include placing expert advisors from the U.S. with host government ministries, providing legal training and conducting skills workshops and bringing policymakers, regulators, and educators to the U.S. for individualized consultations or formal training or educational programs.

The CLDP taps experienced attorneys from both the public and private sectors to serve as advisors. Advisors are required to have substantial expertise in the subject of their assignment and the interests of their host countries.

In order to ensure that its programs are responsive to actual needs and are well coordinated with those of other assistance providers, the CLDP works closely with consular and other host government officials, as well as other U.S. Government, intergovernmental, and non-governmental organizations.

For more information about the CLDP, contact:

Commercial Law Development Program
Office of the General Counsel
U.S. Department of Commerce
14th St. and Constitution Ave., N.W., Room 3845
Washington, D.C. 20230 U.S.A.
Tel: (202) 482-5382 Fax: (202) 482-3244

PREFACE

The *Glossary of Commercial and Trade Law Terms* was undertaken to support the work of the Commercial Law Development Program of the Office of the General Counsel of the U.S. Department of Commerce. It aims to provide explanations of terms used in the training sessions of the Commercial Law Development Program.

This glossary is divided into two sections. The first section provides the terms in alphabetical order in English, followed by the definition in English. The translation of each term and its definition is immediately to the right of the English. The second section is a cross-reference index that gives the translated term first, followed by the term in English. In this way, the glossary may be used with either language.

PARATHËNIE

Fjalorthi i Termave të Ligjit Tregtar u hartua për të ndihmuar punën e Programit të Zhvillimit të Ligjit Tregëtar të Zyrës së Këshilltarit të Përgjithshëm të Departamentit të Tregtësisë së Shteteve të Bashkuara. Ai synon që t'i japë shpjegime termave të përdorur në sesionet e kualifikimit të Programit të Zhvillimit të Ligjit Tregëtar.

Ky Fjalorth është i ndarë në dy pjesë. Në pjesën e parë, termat rradhiten alfabetikisht në anglisht, pasuar nga përcaktimet në anglisht. Përkthimi i çdo termi dhe përcaktimi i tij rradhitën mënjëherë në të djathtë të anglishtes. Pjesa e dytë përfshin treguesin që jep, së pari termin e përkthyer, pastaj termin në anglisht. Në këtë mënyrë, fjalorthi mund të përdoret në të dy gjuhët.

AFFIRMATIVE COVENANT--A covenant in which the party binds himself or herself either to the existence of a present state of facts as represented or to the future performance of some act. An affirmative covenant is an agreement whereby the covenantor undertakes that something will be done.

BALANCE SHEET--A summary statement of a financial position of an economic unit, disclosing its assets and liabilities as of a specific date in conformity with generally accepted accounting principles.

BANKER'S ACCEPTANCE--A draft (q.v.) drawn on and accepted by a bank. If the bank's creditworthiness is sufficiently strong, the acceptance may become a tradable financial instrument.

BILATERAL INVESTMENT TREATY (BIT)--A treaty between the United States and another country that ensures that investments made by nationals of the other country are given national or most-favored-nation treatment, prohibits the imposition of performance requirements (q.v.), and allows one country's investors to employ top management in the other foreign country without regard to nationality. BITs ensure the right to make investment-related transfers, and they guarantee that expropriation (q.v.) takes place only in accordance with accepted international law. BITs also guarantee access by an investing party to impartial and binding international arbitration and dispute settlement.

KONVENTË POZITIVE--Një konventë nëpërmjet së cilës njëra palë merr përsipër dhe detyron vetveten të pranojë një gjëndje ekzistuese të fakteve ashtu siç paraqiten ose të kryejë disa veprime në të ardhmen. Një konventë pozitive është një marrëveshje, sipas së cilës nënshkruesi angazhohet se do të kryejë diçka.

BILANC--Dokument përmbledhës i gjëndjes financiare të një njësie ekonomike, në të cilën pasqyrohen pasuria (të ardhurat dhe kapitali--në para e në natyrë) si dhe detyrimet e kësaj njësie në një datë të caktuar në përputhje me parimet përgjithësisht të pranura të kontabilitetit.

LETËR-PRANIMI BANKAR--Një çek ose urdhër pagese (Shih: Çek) i lëshuar dhe i pranuar nga një bankë. Në qoftë se aftësia kredituese e bankës është mjaft e fuqishme, letër-pranimi mund të shkëmbehet si një instrument financiar.

TRAKTAT BILATERAL INVESTIMESH (TBI)--Një traktat që nënshkruhet ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe një vendi tjetër për t'i siguruar investimet e shtetasve të secilit prej këtyre vendeve, trajtim të njëjtë kombëtar ose atë të kombit më të favorizuar; traktati ndalon vënien e kushteve shtetërore (Shih: Përbushja e Kërkesave Shtetërore) për ekzekutimin e tij, si dhe lejon investitorët e njërës vend të punësojnë drejtuesit (menexhuesit) kryesorë në vendin tjetër pavarësisht nga shtetësia e tyre. TBI siguron të drejtën për të bërë transferime që kanë të bëjnë me investimet, si dhe garanton kryerjen e shpronësimeve (Shih: Shpronësim) vetëm në përputhje me të drejtën e pranuar ndërkombëtare. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, TBI i garanton gjithashtu palës investuese të drejtën t'i drejtohet një arbitrazhi ndërkombëtar të paanshëm, vendimet e të cilit

janë të detyrueshme për t'u
zbatuar.

BILL OF LADING--A document evidencing receipt of goods for shipment issued by a person engaged in the business of transporting or forwarding goods; includes an airbill. An instrument in writing, signed by a carrier or his agent, describing the freight so as to identify it, stating the name of the consignor, the terms of the contract for carriage, and agreeing or directing that the freight be delivered to the order or to the assigns of a specified person at a specified place.

POLICË NGARKESË (FATURË NGARKESË)--Një dokument që dëshmon për marrjen në dorëzim të mallit që do të transportohet, lëshuar nga një person që merret me transportin ose dërgimin e mallrave (transportuesi); përfshihet edhe fatura e transportit ajror. Një instrument me shkrim, nënshkruar nga transportuesi ose nga ndonjë agjent i tij, ku shënohet emri i mallit që do të transportohet, emri i dërguesit të mallit, kushtet e kontratës së transportit, si dhe pranimin nga transportuesi që malli do t'i dorëzohet personit të caktuar (marrësi) në vendin e caktuar.

CASH FLOW--Cash receipts minus disbursements from a given asset or economic activity for a given period. Cash flow differs from net income and refers to the amount of cash remaining after all related disbursements are made, whether they are tax deductible or not.

PARAJA PËR QARKULLIM--Të hollat e arkëtuara prej faturave të ndryshme pasi zbriten shpenzimet ose pagesat e bëra nga një fond pasuror ose nga një aktivitet ekonomik brënda një periudhe të dhënë. Paraja për qarkullim ndryshon nga të ardhurat neto; ajo ka të bëjë me shumën në të holla që mbetet pasi janë kryer të gjitha shpenzimet ose pagesat përkatëse, pavarësisht nëse këto përjashtohen ose jo nga taksat.

CERTIFICATE OF INSPECTION--A document certifying that merchandise (such as perishable goods) was in good condition immediately prior to shipment. Preshipment inspection is a requirement for the importation of goods into many countries.

FLETË KONTROLLI (CERTIFIKATË E INSPEKTIMIT)--Një dokument që vërteton se malli (siç janë prodhimet që prishen ose skadojnë shpejt) ishte në gjëndje të mirë menjëherë para transportit. Kontrolli para transportit është i detyrueshëm për importimin e mallrave në shumë vende të botës.

CERTIFICATE OF ORIGIN--Certain nations require a signed statement as to the origin of an export item. Such certificates are obtained either from a government entity or from a semiofficial organization such as a local chamber of commerce. A certificate may be required even though the commercial invoice (q.v.) contains the information.

CERTIFIKATA E ORIGJINËS--Disa vende kërkojnë një deklaratë të nënshkruar për origjinën e një malli eksporti. Certifikata të tilla sigurohen nga një zyrë shtetërore ose nga një organizatë gjysëm zyrtare, siç mund të jetë dhoma e tregëtisë. Një certifikatë e tillë mund të kërkohet edhe në qoftë se fatura tregëtare (Shih: Faturë Tregëtare) i përmban të dhënat e

çertifikatës.

CLEAN BILL OF LADING--A receipt for goods issued by a carrier with an indication that the goods were received in "apparent good order and condition," without damage or other irregularities.

COLLATERAL--Property that is promised as security for the satisfaction of a debt. Collateral is additional security for the performance of a principal obligation. May include accounts, contract rights, and chattel paper.

COMMERCIAL INVOICE--A bill for the purchase price and other costs for goods from the seller to the buyer. These invoices are often used by governments to determine the true value of goods for the assessment of customs duties (q.v.) and also are used to prepare consular documentation. Governments using commercial invoices to control imports often specify their form, content, number of copies, language to be used, and other characteristics.

COMMON EXTERNAL TARIFF--A uniform tariff (q.v.) adopted by parties to a customs agreement union to be assessed on imports entering the union territory from countries outside the union.

POLICË E PASTËR (FATURË E PASTËR E DORËZIMIT TË NGARKESËS)--Një faturë e lëshuar nga transportuesi për dorëzimin e mallrave, në të cilën vihet shënimi, se mallrat "në dukje u dorëzuan në rregull dhe në gjëndje të mirë," të padëmtuara si dhe pa ndonjë parregullsi tjetër.

SIGURIM HUAJE--Pasuria që premtohet si garanci për të siguruar përmbushjen e një borxhi. Sigurimi i huas është një sigurim plotësues për përmbushjen e një detyrimi kryesor. Mund të përfshijë llogari, të drejta kontraktore, si dhe dokumenta të tjera shkresore që evidentojnë detyrimin monetar dhe interesin ose mbajtjen (me qira ose në ndonjë formë tjetër) e disa mallrave të veçanta.

FATURË TREGËTARE--Një faturë për çmimin e blerjes dhe shpenzimet e tjera në lidhje me mallrat që kalojnë nga shitësi tek blerësi. Këto fatura shpesh përdoren nga qeveritë për të përcaktuar vlerën e vërtetë të mallrave, për të vlerësuar e përlllogaritur taksat (Shih: Taksë) doganore e për të kryer veprimet konsullore. Qeveritë i përdorin faturat tregëtare për të kontrolluar importet e tyre dhe shpesh për të specifikuar formën e tyre, përmbajtjen e tyre, numrin e kopjeve, gjuhën që duhet përdorur dhe karakteristikat të tjera të tyre.

TARIFË E JASHTME E PËRBASHKËT--Zbatimi i një tarife (Shih: Tarifë) të njejtë të vendosur ndërmjet tyre nga shtetet palë në një marrëveshjeje për bashkim doganor, ndaj importeve të shteteve të tjera që hyjnë në territorin e shteteve palë të kësaj marrëveshjeje.

CONDITION PRECEDENT--A condition that must happen or must be performed before some right dependent thereon accrues or before some act dependent thereon is performed. A fact or event, other than a mere lapse of time, that must exist or occur before a duty of immediate performance of a promise arises.

A condition precedent is a requirement that is to be satisfied before an agreement becomes effective. It calls for the happening of some event, or the performance of some act, after the terms of the agreement have been fixed but before the contract is binding on the parties. For example, under a disability insurance contract, the insured is required to submit proof of disability before the insurer is required to compensate him or her for that disability.

CONFIRMED LETTER OF CREDIT--Type of letter of credit (q.v.) in which a local bank (the confirming bank) gives its guarantee that a seller's draft (q.v.) will be honored if the bank that issued the letter (the issuer) fails to honor it.

CONSIGNMENT--Delivery of merchandise from a seller (the consignor) to an agent (the consignee) under an agreement that the agent will sell the merchandise for the account of the seller. The consignor retains title to the goods until they are sold. The consignee sells the goods for a commission and remits the net proceeds to the consignor.

CONTINGENT LIABILITY--An obligation that is not now fixed and absolute but will become fixed and absolute upon the occurrence of some future and uncertain

KUSHTI PARARENDËS--Një kusht që duhet të vërtetohet ose duhet të ndodhë përpara se të sigurohet ndonjë e drejtë ose të kryhet një veprim. Duhet të ekzistojë një fakt ose të ndodhë një ngjarje, dhe jo thjesht të mbarojë (skadojë) ndonjë afat kohor, përpara se të përmbushet një detyrim i caktuar.

Kushti pararendës është një kërkesë që duhet të plotësohet ose të vërtetohet përpara se një marrëveshje të fillojë të zbatohet. Ai kërkon ndodhjen e ndonjë ngjarjeje ose kryerjen e ndonjë veprimi, pasi marrëveshja të jetë lidhur ose nënshkruar, por përpara se kërkesat kontraktore që përmbahen në marrëveshje të bëhen detyruese për t'u zbatuar. P.sh., sipas kontratës së sigurimit për paaftësi, të siguruarit i kërkohet të provojë gjëndjen e paaftësisë përpara se siguruuesit t'i kërkohet të kompensojë atë (të siguruarin) për paaftësi.

LETËR KREDIE KONFIRMUESE--Një dokument i ngjashëm me letrën e kredisë (Shih: Letër Kredie), me anën e së cilës banka e një vendi (banka konfirmuese) garanton se çeku (Shih: Çek) ose urdhër-pagesa e një shitësi do të pranohet ose do të paguhet prej saj në qoftë se banka që e ka lëshuar letrën (lëshuesi) nuk e pranon ose e paguan atë (çekun ose urdhër-pagesën).

AKT-DORËZIM I NGARKESËS--Dërgimi i mallit nga shitësi (dorëzuesi) tek një agjent transporti (marrësi i ngarkesës), sipas marrëveshjes që malli të shitet nga agjenti për llogari të shitësit. Dorëzuesi ruan të drejtën e pronësisë mbi mallin derisa ky të shitet. Marrësi e shet mallin përkundrejt një shpërblimi, ndërsa të ardhurat e tjera ia jep dorëzuesit.

DETYRIM I MUNDSHËM--Një detyrim që për momentin nuk është i përcaktuar dhe absolut, por që bëhet i tillë me vërtetimin (ndodhjen) e ndonjë ngjarje të paparashikuar.

event.

COST AND FREIGHT (CFR)--Under this term, the seller quotes a price for goods that includes the cost of their transportation to a named point of debarkation. The cost of insurance is left to the buyer's account. (Typically used for ocean shipment only. CPT, or carriage paid to, is a term used for shipment by modes other than ocean shipment.) Also defined as a method of import valuation (q.v.) that includes insurance and freight charges with the merchandise values.

KOSTUA DHE NGARKESA (KN)--Sipas këtij termi, shitësi cakton çmimin e mallrave, i cili përfshin shpenzimet për transportimin e tyre deri në vendin e caktuar të shkarkimit. Kostua e sigurimit lihet për llogari të blerësit. (Ky term përdoret vetëm për transportin detar. Ngarkesë e Paguar (NP) është termi që i referohet transportimeve me mjete të tjera.) Gjithashtu përdoret si metodë e vlerësimit (Shih: Vlerësimi) të importit që përfshin pagesat e sigurimit dhe të transportit të ngarkesës si dhe vlerën e mallit.

COST, INSURANCE, AND FREIGHT (CIF)--Under this term, the seller quotes a price for goods, insurance, transportation, and miscellaneous charges to the point of debarkation for the vessel. (Typically used for ocean shipment only. CIP, or carriage and insurance paid to, is a term used for shipment by modes other than ocean shipment.)

KOSTUA, SIGURIMI DHE NGARKESA (KSN)--Sipas këtij termi, shitësi cakton çmimin për mallrat, për sigurimin, për transportin dhe për shpenzimet e tjera deri në ankorimin e anijes për shkarkimin e mallrave. (Përdoret vetëm për transportin detar. Ngarkesë dhe Sigurim i Paguar (NSP) përdoret për transportimet me mjete të tjera.)

COST OF PRODUCTION--A term used to refer to the sum of the cost of materials, the fabrication, and other processing employed in producing merchandise, and the appropriate allocations of general administrative and selling expenses. The cost of production is based on the producer's actual expenses and does not include mandatory minimum general expenses or profit, both of which are used when determining constructed value. Constructed value consists of the cost of materials and fabrication and other processing employed in producing merchandise, general expenses of not less than 10 percent of material and fabrication costs, and profit of not less than 8 percent of the sum of production costs and general expenses.

KOSTO PRODHIMI--Ky term i referohet shumës së kostos së materialeve, të fabrikimit, dhe të proceseve të tjera që nevojiten për prodhimin e një malli, si dhe sasia e duhur e shpenzimeve të përgjithshme administrative dhe ato të shitjes. Kosto e prodhimit bazohet në shpenzimet faktike të prodhuesit dhe nuk përfshin shpenzimet e përgjithshme minimale të detyrueshme ose fitimin, që së bashku nevojiten për të përcaktuar vlerën e përgjithshme. Vlera e përgjithshme përbëhet nga kostua e materialeve, e fabrikimit dhe e proceseve të tjera që nevojiten për prodhimin e një malli, nga shpenzimet e përgjithshme që janë jo më pak se 10 përqint e shpenzimeve të materialeve dhe të fabrikimit, si dhe nga fitimi që është jo më pak se 8 përqint e shumës së shpenzimeve të prodhimit dhe shpenzimeve të përgjithshme.

COUNTERTRADE--An umbrella term for several types of trade in which the seller is required to accept goods, services (q.v.), or other instruments of trade, in partial or whole payment for the goods or services it is selling. Forms of countertrade include barter, triangular trade, offsets, and bilateral clearing accounts.

COUNTERVAILING DUTY--A charge that a country places on imported goods in addition to the standard tariff (q.v.) to which the goods would be subject in order to counter the value of subsidies (q.v.) or bounties granted to the exporters or producers of the goods by their home governments.

COVENANT--An agreement between two or more parties by which one of the parties promises to the other that something either has been done, will be done, or will not be done or that stipulates the truth of certain facts. The term is currently used primarily with respect to promises in conveyances or other instruments relating to real estate. In its broadest usage, a covenant is any agreement or contract.

CREDIT REPORT--A document from a credit evaluation organization rating the creditworthiness and pertinent financial data concerning a person or a company. Used by banks, merchants, suppliers, and others to evaluate the credit risk (q.v.) of doing business with that person or company.

TREGËTI ME KLERING (TREGËTI MALL ME MALL)--Një term përgjithsues për disa lloj tregëtish, në të cilat shitësit i kërkohej të pranojë mallra, shërbime (Shih: Shërbimet) ose instrumente të tjera tregëtie, si pagesa të pjesshme ose të plota për mallrat ose shërbimet që shitësi shet ose bën. Format e tregëtise me kliring përfshijnë shkëmbime të ndryshme, tregëtinë tre-palëshe, kompensimet me mall, si dhe shlyerjet dypalëshe të llogarive.

TAKSË DOGANORE PLOTËSUESE--Një taksë që vendoset nga një vend për mallrat e importuara, përveç tarifave (Shih: Tarifë) standarte të zakonshme, ndaj vlerës së subvencioneve (Shih: Subvencion), ndihmave ose donacioneve që eksportuesit ose prodhuesit e mallrave kanë përfituar nga qeveritë e vendeve të tyre.

KONVENTË--Një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve, nëpërmjet së cilës njëra palë i angazhohet dhe i premtos tjetrës në lidhje me një diçka, e cila ose është bërë ose do të bëhet ose nuk do të bëhet, ose që përcakton vërtetësinë e disa fakteve. Ky term tashmë përdoret kryesisht në lidhje me aktet ose instrumentet që kanë të bëjnë me kalimet e pronësisë së paluajtshme. Në përdorimin e saj më të gjërë, konventa është çdo marrëveshje ose kontratë.

RAPORT KREDIE--Një dokument studimor i bërë nga një organizatë e specializuar vlerësimi për akordimin e kredisë, me anën e të cilit jepen të dhëna mbi gjëndjen financiare të një personi ose shoqërie, si dhe mendimi për akordimin ose jo të kredisë personit ose shoqërisë në fjalë. Një dokument i tillë përdoret nga bankat, tregëtarët, furnizuesit, etj., për të vlerësuar rreziqet (Shih: Rreziku) që i vinë kredisë nga veprimtaria që do të kryhet me një person ose me një shoqëri të caktuar.

CUSTOMS DUTY--See: Tariff.

TAKSË DOGANORE--Shih: Tarifë

DATE DRAFT--A draft (q.v.) that matures (becomes payable) a specified number of days after the date it is issued, without regard to the date of acceptance.

CEK I DATUAR--Çeku (Shih: Çek) që bëhet i pagueshëm pas kalimit të një numri të caktuar ditësh nga data e lëshimit të tij, pavarësisht nga dita e pranimit të tij.

DEBT FINANCING--Raising of funds by issuing bonds or notes or borrowing from a financial institution. Borrowing of money generally on a long-term basis for acquiring working capital or for retiring current indebtedness. Debt financing creates an obligation to repay the principal amount of the debt plus interest (q.v.) that accrues over time at a fixed or variable rate. This is contrasted with equity financing (q.v.), which is the raising of funds by selling ownership interests.

FINANCIMI I BORXHIT--Rritja e fondeve nëpërmjet lëshimit të obligacioneve ose notave (instrument i një lëshuesi se do të paguajë një shumë të caktuar parash brënda një periudhe kohe të caktuar) ose duke marrë hua nga një institucion financiar. Marrja borxh e parave bëhet përgjithësisht me afat të gjatë për të siguruar kapital punues ose për të dalë nga gjëndja faktike e borxheve. Financimi i borxhit krijon detyrimin për të paguar shumën kryesore të borxhit plus interesin (Shih: Interesi) që fitohet gjatë kohës në një përqindje të caktuar ose të ndryshshme. Kjo ndryshon nga financimi i pasurisë (Shih: Financimi i Pasurisë), e cila ka të bëjë me sigurimin e fondeve duke shitur interesat e pronësisë.

DEFAULT--A failure or an omission of that which ought to be done. Specifically, the omission or failure to perform a legal contractual duty, to observe a promise or discharge an obligation (e.g., to pay interest (q.v.) or principal on a debt when due), or to perform an agreement. The term also embraces the idea of dishonesty, a wrongful act, or an act of omission discreditable to one's profession.

MOSPËRMBUSHJE, MOSSHLYERJE--Dështim ose moskryerja ose moszbatimi i një dërkaje që duhet bërë. Veçanërisht, dështimi ose moszbatimi i një detyrimi kontraktor, i një premtimi, i një marrëveshjeje, i një detyrimi (p.sh., kryerja e pagesës së interesit (Shih: Interesi) ose të pjesës kryesore të një borxhi në kohën e duhur). Ky term përfshin gjithashtu qëndrimin e pandershëm, veprimin e gabuar ose mosveprimin që diskretiton një profesion.

DELIVERED DUTY PAID--Under this term, the seller specifies that the price of the seller's goods includes payment of any duties (q.v.) applicable thereto. Whereas the term "Ex Works" signifies the seller's minimum obligation, the term "delivered duty paid," when followed by

TAKSË DOGANORE E PAGUAR PËR TRANSPORT--Sipas këtij termi, shitësi specifikon se çmimi i mallrave të tij përfshin pagimin e çdo takse (Shih: Taksë) doganore të zbatueshme. Ndërsa termi "Punë Ex" do të thotë detyrim minimal i shitësit, termi "taksë doganore e paguar për transport," kur është

words naming the buyer's premises, denotes the other extreme--the seller's maximum obligation. The term "delivered duty paid" may be used regardless of the mode of transport. If the parties wish that the seller clear the goods for import duty, but that some of the cost payable upon the import of the goods should be excluded--such as the value-added tax (VAT, g.v.) and/or other similar taxes--this should be made clear by adding words to this effect (e.g., "exclusive of VAT and taxes").

i shoqëruar me fjalët që tregojnë selinë e blerësit, do të thotë ekstremin tjetër--detyrimin maksimal të shitësit. Termi "taksë doganore e paguar për transport" mund të përdoret pavarësisht nga mënyra e transportimit. Në qoftë se palët dëshërojnë që shitësi t'i paguajë taksat doganore të importit për mallrat, por duke përjashtuar disa nga shpenzimet për importimin e mallrave-si tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) (Shih: Tatim mbi Vlerën e Shtuar) dhe/ose ndonjë taksë tjetër të ngjashme, një gjë e tillë duhet të bëhet e qartë duke shtuar fjalët përkatëse (p.sh., "duke përjashtuar TVSH dhe taksat").

DRAFT--A written order made by one party (the drawer) instructing a second party (the drawee, typically a bank) to pay a third party (the payee) a certain sum of money either upon proper presentation of the order (a sight draft) or at a definite time after presentation of the order (a time draft).

CEK (URDËR-PAGESE)--Një urdhër me shkrim lëshuar nga njëra palë (lëshuesi), me anën e të cilit i kërkon një pale tjetër (paguesi--në pozitën e paguesit zakonisht është një bankë) t'i paguajë një pale të tretë (prurësit) një shumë të caktuar parash menjëherë me paraqitjen e çekut (çek për pagesa të menjëherëshme) ose në një kohë të caktuar pas paraqitjes së çekut (çek i kushtëzuar në kohe).

DRAFT BILL OF EXCHANGE--A written, unconditional order for payment from one person (the drawer) to another person (the drawee). It directs the drawee to pay a specified sum of money, in a given currency, at a specific date to the drawer. A sight draft calls for immediate payment (on sight or presentation) whereas a time draft calls for payment at a readily determined future date.

CEK KËMBYES--Një urdhër pagese me shkrim dhe i pakushtëzuar i lëshuar nga një person (lëshuesi) për një person tjetër (paguesi). Ai e urdhëron paguesin të paguajë një shumë të caktuar parash, në një monedhë të dhënë, në një datë të caktuar. Një çek që paraqitet kërkon pagimin e tij të menjëhershëm (me dorëzimin e tij), ndërsa një çek i datuar (i kushtëzuar në kohë) kërkon pagimin e tij në një datë të caktuar në të ardhmen.

DUMPING--The sale of a commodity in a foreign market at less than fair value. Dumping is usually recognized as unfair because the practice can disrupt markets and injure producers of competitive products in an importing country. Article IV of GATT permits imposition of antidumping duties

DUMPING--Shitja e një malli në një treg të huaj me një çmim më të ulët se sa i takon. Dumpingu konsiderohet si një tregëti e padrejtë pasi një praktikë e tillë mund të çrregullojë tregjet dhe të dëmtojë prodhuesit e produkteve konkurrues në një vend importues. Neni IV i GATT-it e lejon

equal to the difference between the price sought in the importing country and the normal value of the product in the exporting country.

DUTY--See: Tariff.

ENCUMBRANCE--Any right to, or interest in, personal property or real property belonging to another to the diminution of its value, but consistent with its conveyance. A claim, lien (q.v.), charge, or liability attached to and binding on property, typically, real property (e.g., a mortgage (q.v.), judgment lien, mechanics' lien, lease, security interest, easement or right of way). If the liability relates to a particular asset, the asset is said to be encumbered.

EQUITY FINANCING--Raising of capital by a corporation by issuing (selling) shares. Shares represent ownership interests in the issuer of the shares, entitling the purchaser to a portion of the value of the issuer, and various appurtenant rights, but not entitling the purchaser to a fixed or guaranteed value in the event the purchaser sells the shares or the issuing company is dissolved. This is contrasted with debt financing (q.v.), which is the raising of capital by issuing bonds or borrowing money.

ESCAPE CLAUSE--Generally, a provision in a contract or other document permitting a party or parties to

vendosjen e detyrimeve doganore kundër dumpingut të barabartë me vleftën që del nga diferenca ndërmjet çmimit që kërkohet në vendin importues me vlerën normale të produktit në vendin eksportues.

TAKSA--Shih: Tarifë.

BARRË--Çdo e drejtë ose interes mbi një pasuri personale ose pasuri të palujtshme që i përket diku tjetër dhe që i ul vlerën asaj, por që nuk vjen në kundërshtim me mbajtësin e titullit të pronësisë. Çdo pretendim, mjet për sigurimin e ekzekutimit (Shih: Mjet sigurimi i Detyrimit) të detyrimit, detyrim tjetër që i bashkëngjitet dhe ka lidhje me pronësinë, sidomos, me pronën e palujtshme (p.sh., hipoteka (Shih: Hipotekë), mjetet e tjera për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit që vendosen me vendim gjyqësor, privilegjet, qiratë, interesat e sigurimit, uzufruktet ose servitutet). Në qoftë se detyrimi lidhet me një pasuri të veçantë, në këtë rast thuhet se pasurisë i është vënë një barrë.

FINANCIMI I PASURISË--Rritja e kapitalit nga një shoqëri nëpërmjet lëshimit (shitjes) të aksioneve. Aksionet përfaqsojnë interesat pasurore (në proporcion me pjesët e aksionmbajtësve) të shitësit, duke i kaluar blerësit të drejta për një pjesë të vlerës së pasurisë së tij (shitësit), si dhe një sërë të drejtash që lidhen me të, por duke i hequr të drejtën blerësit mbi një vlerë të caktuar ose të garantuar në rast se blerësi shet aksionet ose në rast shpërndarje të shoqërisë. Kjo ndryshon nga financimi i borxhit (Shih: Financimi i Borxhit), i cili ka të bëjë me rritjen e kapitalit nëpërmjet lëshimit të obligacioneve dhe marrjes së huave.

KLAUZOLË PËRJASHTUESE--Si rregull, është fjala për një klauzolë që përmbahet në një kontratë ose

change the standard terms of the contract or document, or to avoid liability or performance under certain conditions. In the context of international trade, for example, an international tariff (q.v.) schedule may provide that the ordinary tariff may be increased if imports covered by such tariffs cause harm to domestic industries producing like goods.

The escape clause section of Article XIX of GATT allows countries to temporarily violate their GATT obligations to the degree and for the time necessary to protect a domestic industry from serious injury. Countries taking such actions, however, must consult with affected contracting parties to determine appropriate compensation for the violation of GATT rights, or be subject to retaliatory trade actions.

ndonjë dokument tjetër që lejon një palë ose palët të ndryshojnë kushtet standarte të kontratës ose të dokumentit, ose të shmangin përgjegjësinë ose ekzekutimin në kushte të caktuara. Për shëmbull, në kontekstin e tregëtisë ndërkombëtare, lista ndërkombëtare e tarifave (Shih: Tarifë) mund të parashikojë rritjen e një tarife të zakonshme, në qoftë se importet e mbuluara nga tarifa të tilla ndërkombëtare i shkaktojnë dëm industrisë së brendshme të një vendi që prodhon të njëjtat mallra.

Klauzola përjashtuese e Nenit XIX të GATT-it i lejon vendet anëtare të shkelin përkohësisht detyrimet e tyre që rrjedhin nga GATT-i në masën dhe për një periudhë kohe të nevojshme për të mbrojtur industrinë e brendshme nga dëmtimet serioze. Megjithatë, vendet që ndërmarrin veprime të tilla duhet medoemos të konsultohen me palët kontraktuese të ndikuara nga këto veprime për të përcaktuar kompensimin përkatës lidhur me shkeljen e të drejtave të GATT-it, përndryshe ato do t'i nënshtrohen veprimeve hakmarrëse tregëtare.

EXCHANGE RATE--The value of one country's currency in terms of the value of another country's currency, e.g., dollar vs. pound.

KURS KËMBIMI--Vlera e monedhës së një vendi e krahasuar me vlerën e monedhës së një vendi tjetër, p.sh., dollari i krahasuar me stërlinën.

EXPORT CONTROL--Governmental restrictions on the export of certain goods or services (q.v.) for economic, political, or security reasons. Export controls may take the form of requiring special licenses for such goods or services.

KONTROLL I EKSPORTIT--Kufizimet shtetërore mbi eksportin e disa mallrave ose shërbimeve (Shih: Shërbimet) për arësye ekonomike, politike ose sigurimi. Kontrolli i eksporteve mund të bëhet në formën e dhënies së licencave të veçanta, mbi kërkesën e të interesuarve, për mallra ose shërbime të tilla.

EXPORT LICENSE--A government document authorizing the export of specific goods in specific quantities to a particular destination. The document may be

LICENCË EKSPORTI--Një dokument shtetëror që autorizon eksportin e mallrave të veçanta në sasi të caktuara për një destinacion të caktuar. Dokumenti mund të

required in some countries for most or all exports and in other countries only under special circumstances.

kërkohej në disa vende për shumicën ose të gjithë eksportet, ndërsa në vende të tjera vetëm në rrethana të veçanta.

EXPORT PROMOTION--A program to help companies sell products abroad. These programs may include business counseling, training, and representational assistance, as well as providing market research information, trade-fair opportunities, and export financing assistance.

NXITJA E EKSPORTIT--Programi që ndihmon njësitë ekonomike të shesin prodhimet e tyre jashtë shtetit. Një program i tillë mund të përfshijë konsultimet mbi biznesin, trejnimin dhe ndihma nëpërmjet përfaqsimit, si dhe dhënia e informacioneve mbi gjëndjen e tregut, krijimi i mundësive për një tregëti të drejtë dhe dhënien e ndihmës për financimin e eksportit.

EXPROPRIATION--A taking, as of privately owned property, by the government under eminent domain. This term is frequently used in the context of a government taking the property or assets of a foreign-owned company, in which case international law requires that the expropriating government offer prompt, adequate, and effective compensation for such taking to the person or company whose property was expropriated.

SHPRONËSIM--Marrja nga qeveria e një prone private që përfshihet në një fushë të rëndësishme të interesit shtetëror. Ky term zakonisht përdoret në kontekstin kur një qeveri merr pronën ose pasuritë që zotërohen nga një shoqëri e huaj; në një rast të tillë e drejta ndërkombëtare kërkon që qeveria shpronësuese t'i ofrojë personit ose shoqërisë që shpronësohet një kompensim të menjëhershëm, të përshtatshëm dhe efektiv.

FACTORING--The discounting of an account receivable that does not involve a draft (q.v.). The seller transfers title to the seller's accounts receivable to a factoring house for cash at a discount from the face value of the accounts. Factoring often is done without recourse to the seller. Export factoring allows an exporter to ship on "open account," (q.v.) by which goods are shipped without guarantee of payment (i.e., a letter of credit (q.v.)). The factor assumes the financial ability of the customer to pay and handles collections on the receivables.

VEPRIMTARI NË QENDRËN TREGËTARE--Zbritja e një detyrimi në një llogari pa paraqitjen e ndonjë çeku (Shih: Çek). Shitësi transferon tituj pronësie nëpërmjet përdorimit të llogarive të tij tek një qendër tregëtare si shkëmbim për të marrë para në dorë, duke pakësuar ose zbritur në këtë mënyrë vlerën e llogarive. Pakësimi ose zbritja në vlerë e llogarive shpesh kryhet pa iu drejtuar shitësit. Kryerja e veprimeve të tilla për eksport e lejon eksportuesin të dërgojë një "llogari të hapur" (Shih: Llogari e Hapur), nëpërmjet të cilës mallrat transportohen pa ndonjë pagesë të garantuar, d.m.th., pa një letër kredie (Shih: Letër Kredie). Qendra e tregëtisë merr përsipër mundësinë financiare të një klienti për të paguar si dhe përgjigjet për shumat e mbledhura në debinë e llogarisë së tij.

FORCE MAJEURE--The title of a standard clause in a contract exempting the parties for nonfulfillment of their obligations as a result of conditions beyond their control, such as earthquakes, floods, or war.

FORFAITING--A form of supplier credit in which a seller surrenders possession of receivables, which are usually guaranteed by a bank in the purchaser's country, by selling them at discount to a "forfeiter" in exchange for cash. These instruments also may carry the guarantee of the importer's government. In a typical forfaiting transaction, a seller approaches a forfeiter before completing a transaction's structure. Once the forfeiter commits to the deal and sets the discount rate, the seller can incorporate the discount into the selling price. Forfaiters usually work with bills of exchange or promissory notes (q.v.), which are unconditional and easily transferable debt instruments that can be sold on the secondary market.

There are three main differences between export factoring and forfaiting:

- 1) Factors usually want access to a large percentage of a seller's business, whereas forfaiters will work on a single transaction basis;
- 2) Forfaiters generally work with medium-term and long-term receivables (180 days to seven years), whereas factors work with short-term receivables (up to 180 days). Payment terms usually reflect the type of product involved: forfaiters usually work with capital goods, commodities, and large projects; factors work mostly with consumer goods; and
- 3) Most factors do not have strong capabilities in developing countries, where legal and financial frameworks are inadequate and where credit information is not readily available through affiliate factors. Forfaiters usually

FORCE MADHORE--Titulli i klauzolës standarte në një kontratë që përjashton përgjegjësinë e palëvet nga mospërbushja e detyrimeve për shkak të disa rrethanave të jashtëzakonshme që dalin jashtë kontrollit të palëve, siç janë tërmetet, përmytjet ose lufta.

HUMBJE, ZHVESHJE NGA PRONËSIA--Një formë e mbulimit të kredisë sipas së cilës një shitës heq dorë nga posedimi i të ardhurave nga shitja e mallrave, të cilat janë zakonisht të garantuara nga një bankë në vendin e blerësit, duke i shitur ato me zbritje tek një likujdator dhe duke marrë si shkëmbim para në dorë (kesh). Ky instrument, gjithashtu mund të bartë edhe garancinë e qeverisë së vendit importues. Në një transaksion tipik me pasoja humbjeje, shitësi i drejtohet një likujdatori përpara se të përfundojë plotësisht transaksioni. Pasi likujdatori angazhohet dhe përcakton kursin e zbritjes, shitësi mund ta përfshijë këtë zbritje në çmimin e shitjes. Likujdatorët zakonisht punojnë me çek këmbimi ose me nota premtuese (Shih: Nota Premtuese) të cilat janë të pakushtëzuara si dhe janë instrumente detyrimesh lehtësisht të transferueshme që mund të shiten në tregje dytësorë.

Tre janë dallimet kryesore ndërmjet veprimeve të agjentëve ose komisionerëve të qëndrave tregëtare të eksportit dhe likujdatorëve:

- 1) Agjentët preferojnë të hyjnë me përqindje të lartë në biznesin e shitësit, ndërsa likujdatorët punojnë mbi baza transaksionesh të veçantë;
- 2) Likujdatorët përgjithësisht punojnë me kreditime afat-mesme dhe afat-gjata (nga 180 ditë deri në 7 vjet), ndërsa agjentët punojnë me kreditime afat-shkurtëra (deri në 180 ditë). Afatet në pagesa zakonisht pasqyrojnë tipin e produktit që është objekt veprimtarie: likujdatorët zakonisht punojnë me mallra e artikuj tregëtie, si dhe me projekte të mëdha; ndërsa

require a bank guaranty (q.v.), which makes them more willing to work with receivables from these countries.

agjentët në shumicën e rasteve punojnë me artikuj e mallra të konsumit të gjërë;

3) Shumicës së agjentëve ose komisionerëve nuk u paraqiten mundësi të mëdha në vendet në zhvillim, ku kuadri ligjor dhe financiar është i papërshtatshëm dhe ku informacioni mbi kredinë nuk është ende i mundshëm nëpërmjet agjentëve përfaqësues. Likujdatorët zakonisht kërkojnë një garanci bankare (Shih: Garantim), e cila i bën ata më të gatshëm të punojnë me të ardhurat nga vendet ku ekzistojnë të tilla garanci bankare.

FORWARD EXCHANGE RATE--The price set between two parties for delivery of a foreign currency on an agreed future date. If the date will occur within a week, the agreement is called a spot transaction; if the date is more than a week in the future, the arrangement is called a forward exchange transaction.

KURS I ARDHSHËM KËMBIMI--Çmimi i caktuar ndërmjet dy palëve për dorëzimin e një monedhe të huaj në një datë të caktuar në të ardhmen. Në qoftë se data e caktuar bie brënda një jave, marrëveshja quhet transaksion i menjëhershëm; në qoftë se data shkon përtej një jave, ajo quhet kurs i ardhshëm këmbimi.

FOUL BILL OF LADING--A receipt for goods issued by a carrier with an indication that the goods were damaged when received.

POLICË NGARKESE DËMTIMI--Faturë malli lëshuar nga një transportues, me anën e së cilës dëshmohet se mallrat kanë qënë të dëmtuara në kohën e ngarkimit.

FREE ALONGSIDE SHIP (FAS)--Sales price that includes all costs of transportation and delivery of the goods to the ship or other carrier.

TRANSPORTIM FALAS DERI TEK ANIJA (TFA)--Çmimet e shitjes që përfshijnë të gjitha shpenzimet e transportit dhe të dorëzimit të mallrave deri tek anija ose tek ndonjë mjet tjetër transporti.

FREE ON BOARD (FOB)--Sales price that includes delivery of the items to the purchaser. The FOB seller assumes all responsibilities and costs up to the point of delivery, including insurance, transportation, and so forth.

TRANSPORTIM FALAS (TF)--Çmimet e shitjes që përfshijnë transportin e mallrave deri tek blerësi. Në rastin e TF, shitësi merr përsipër të gjitha përgjegjësitë dhe shpenzimet deri në dorëzimin e mallrave tek blerësi, duke përfshirë sigurimin, transportin, etj.

FREE TRADE AGREEMENT (FTA)--An arrangement that establishes the unimpeded flow of goods and services (q.v.) between trading partners regardless of national

MARRËVESHJA PËR TREGËTI TË LIRË (MTL)--Një marrëveshje që rregullon qarkullimin pa pengesa të mallrave dhe shërbimeve (Shih: Shërbimet) pavarësisht nga kufijt

borders. An FTA stops short of establishing a common market, which typically provides for labor mobility, common currencies, uniform product standards, or other common policies. Member countries of a free trade area apply their individual tariff (q.v.) rates to countries outside the free trade area.

kombëtarë. MTL-ja nuk synon krijimin e një tregu të përbashkët, i cili zakonisht përmban lëvizjen e lirë të fuqisë punëtore, njësi monetare të përbashkët, standarde uniforme të produkteve ose politika të tjera të përbashkëta. Vendet anëtare të një zone me tregëti të lirë zbatojnë listat e tarifave (Shih: Tarifë) të tyre individuale për vendet jashtë zonës së tregëtisë së lirë.

FREE TRADE ZONES--A generic term referring to special commercial and industrial areas at which special customs procedures allow the importation of foreign merchandise (including raw materials, components, and finished goods) without the requirement that duties (q.v.) be paid immediately. If merchandise is later exported, duty free treatment is given to reexports. The zones are usually located in or near ports of entry. Merchandise brought into these zones may be stored, exhibited, assembled, processed, or used in manufacturing prior to reexport or entry into the national customs territory. When manufacturing activity occurs in free trade zones, it usually involves a combination of foreign and domestic merchandise and usually requires special governmental authority. Free trade zones are sometimes called "customs free zones" or "duty free zones."

Pengu mund të jetë një garanci në formën e interesit mbi një pasuri të luajtshme ose mbi një pasuri jo-materiale të përfaqësuar nëpërmjet një instrumenti të domosdoshëm (një dokument noterial me shkrim për një interes mbi një pasuri jo-materiale, dokument i cili jo vetëm e përfaqëson pasurinë jo-materiale, por vërteton, gjithashtu, se gëzimi, kalimi dhe mbrojtja e një pasurie jo-materiale varet nga posedimi i instrumentit), interes që është krijuar nga marrja peng e një pasurie me qëllim që të sigurohet pagimi i një borxhi ose përmbushja e një detyrimi tjetër. Gjithashtu, pengu është një premtim ose marrëveshje me anën e të cilit pengdhënësi detyron veten të bëjë ose të mos bëjë diçka.

PROMISSORY NOTE--An unconditional written promise, signed by the maker, to pay absolutely and at all events a sum certain in money, either to the bearer or to a person designated in the note or on such person's order, at a time specified therein, or at a time that must certainly arrive.

NOTE PREMTUESE--Një premtim me shkrim dhe pa kushte, i nënshkruar nga lëshuesi i saj, për të paguar në mënyrë absolute dhe pavarësisht nga çdo rrethanë, një shumë të caktuar tek mbajtësi i notës, ose tek personi i caktuar në të ose me urdhër të këtij të fundit, në një kohë të përcaktuar tek nota, ose në një kohë të sigurt në të ardhmen.

QUANTITATIVE RESTRICTION (QR)--An explicit limit imposed by an importing country on the total amount of a specified good that may be imported into a country or that may be imported from any particular supplying country. Compared with a tariff (q.v.), a QR affords protection that tends to be more predictable, because it is less affected by changes in competitive factors. GATT generally prohibits the use of QRs, except in special cases, such as those cited in Article XX (which permits exceptions to protect public health, national gold stocks, goods of archaeological or historic interest, and a few other special categories of goods) or in Article XXI (which permits exceptions in the interest of

KUFIZIMET SASIORE (KS)--Një kufizim i shprehur i vendosur nga vendi importues mbi shumën e përgjithshme të një malli të veçantë që mund të importohet në një vend ose që mund të importohet nga çdo vend furnizues i caktuar. Krahësuar me tarifën (Shih: Tarifë), KS-ja siguron mbrojtjen që është përgjithsisht e nevojshme, pasi kjo ndikohet më pak nga faktorët konkurrenues. GATT-i përgjithësisht ndalon përdorimin e KS-ve, me përjashtim të rasteve të veçantë si ato që përmenden në Nenin XX (i cili lejon përjashtime për mbrojtjen e shëndetit publik, të rezervave kombëtare të arit, të sendeve me interes arkeologjik ose historik, si dhe të disa kategorive mallrash të veçantë) ose në Nenin XXI (i cili lejon përjashtime në

"national security").

interes "të sigurimit kombëtar").

QUOTA--Government-imposed limit on trade in a particular good or service based upon quantity. An absolute quota prevents any trade in excess of a specified limit. A tariff (q.v.) rate quota limits the amount of trade subject to a special tariff rate but leaves open the possibility of additional trade at other rates.

KUOTË--Kufizim shtetëror tregëtar në lidhje me sasinë e një malli ose shërbimi të caktuar. Një kuotë absolute parandalon çdo tregëti të tepërt mbi sasinë e përcaktuar. Kuota me një tarifë (Shih: Tarifë) të caktuar kufizon shumën e tregëtisë që kryhet në bazë të kësaj tarife, por lë të hapur mundësinë e një tregëtie të mëtejshme me tarifa të tjera.

RATE OF RETURN--The income earned on an investment, measured over a specified period of time, generally referred to in terms of a percentage of the value of the investment.

NORMË FITIMI--E ardhura e fituar nga një investim, e përlllogaritur gjatë një periudhe kohe të caktuar, dhe që përgjithsisht shprehet me termat--përqindje e vlerës së investimit.

RECIPROCITY--Relationship in which two countries provide similar rights to each other's nationals; it seeks an approximate equality of concessions accorded and benefits received among or between trading partners. Reciprocity may include the lowering of customs duties (q.v.) on imports in return for tariff (q.v.) concessions from other countries or the negotiated reduction of a country's import duties or other trade restraints in return for similar concessions from another country. Reciprocity is a traditional objective of GATT trade negotiations.

RECIPROCITETI--Marrëdhënia në bazë të së cilës dy vende i njohin shtetasve të njeri tjetrit të drejta të njëjta; ajo kërkon koncesione dhe përfitime përafërsisht të barabarta midis ose ndërmjet partnerëve tregëtare. Reciprociteti mund të përfshijë uljen e taksave doganore (Shih: Taksë Doganore) ndaj importeve si shkëmbim për koncesionet në tarifa (Shih: Tarifë) nga vendet e tjera ose uljen nëpërmjet negociatave të detyrimeve mbi importet të një vendi ose kufizime të tjera tregëtare si shkëmbim për koncesione të njëjta nga një vend tjetër. Reciprociteti është një objektiv tradicional i negociatave tregëtare të GATT-it.

RETALIATION--With regard to international trade, it is an action taken by one country against another country when the first country's exports are adversely affected by the raising of tariffs (q.v.) or other trade-restricting measures of the other country. GATT permits an adversely affected contracting party to impose limited restraints on imports from another contracting party that has raised its trade barriers (after consultations with other

KUNDËRVEPRIMI--Në lidhje me tregëtinë ndërkombëtare, ky term i referohet një veprimi të ndërmarrë nga një vend kundër një vendi tjetër kur eksportet e të parit dëmtohen nga ngritja e tarifave (Shih: Tarifë) ose nga masat e tjera kufizuese tregëtare të vendit tjetër. GATT-i e lejon palën e dëmtuar të vendosi restriksione të kufizuara mbi importet e palës tjetër që ka rritur barrierat e saj tregëtare (pas konsultimesh me palët e tjera të GATT-it, tregëtia e të

GATT contracting parties whose trade might be affected). In theory, the value of trade affected by such retaliatory measures should approximate the value of trade affected by the change that precipitated the retaliation.

cilëve mund të ndikohet). Teorikisht, vlera e tregëtisë që ndikohet nga masa të tilla kundërvepruese duhet t'i përafrohet vlerës së tregëtisë së dëmtuar nga ndryshimi që solli kundërveprimin.

REVOCABLE LETTER OF CREDIT--Type of letter of credit (q.v.) in which the issuing bank reserves the right to cancel and withdraw from the transaction upon appropriate notice.

LETËR KREDIE E REVOKUESHME--Një lloj letër kredie (Shih: Letër Kredie), në të cilën bankës emetuese i rezervohet e drejta të anullojë ose të tërheqë letër kredinë prej një aktiviteti financiar, pasi t'i jetë dhënë njoftimi përkatës palës së interesuar.

RISK--In general, the element of uncertainty in an undertaking. Includes hazard, danger, peril, exposure to loss, injury, disadvantage, or destruction and comprises all elements of danger. Risk may be physical, economic, or political.

In insurance law, defined as the danger or hazard of a loss of the property insured; the casualty contemplated in a contract of insurance; the degree of hazard; a specified contingency or peril; and, colloquially, the specific house, factory, ship, and so forth, covered by the policy.

RREZIKU (RISK)--Në përgjithësi, termi rrezik përfaqson elementin e pasigurisë në një veprimtari. Përfshin të gjitha llojet dhe elementet e rrezikut, humbjet, dëmtimet, disavantazhet ose shkatërrimet. Rreziku mund të jetë fizik, ekonomik ose politik.

Në të drejtën e sigurimit, përkufizohet si rrezik për humbjen e një prone të siguruar; rastësia e parashikuar në një kontratë sigurimi; shkalla e rrezikut; një rastësi specifike ose rrezikshmëria dhe, në të folurën e përditëshme, shtëpia, fabrika, anija e të tjera, që mbulohen nga politika e sigurimit.

RULES OF ORIGIN--The Agreement on Rules of Origin, incorporated in the Uruguay Round Trade Agreements of the General Agreement on Tariff and Trade (GATT), defines the term in Article 1 as those laws, regulations, and administrative determinations of general application applied to determine the country of origin of goods, other than rules related to "contractual or autonomous trade regimes" that provide tariff (q.v.) preferences beyond those required by GATT's most-favored-nation rule.

RREGULLAT E ORIGJINËS--Marrëveshja për Rregullat e Origjinës, e përfshirë në Raundin e Uruguajit të Marrëveshjeve Tregëtare të GATT-it, e përcakton këtë term në Nenin 1 si norma, rregulla dhe vendime administrative të zbatimit të përgjithshëm që zbatohen për të përcaktuar vendin e origjinës së mallit, në dallim nga rregullat që i referohen "regjimeve tregëtare kontraktore ose autonome" që parashikojnë preferenca në taksa (Shih: Taksë), duke përjashtuar ato që kërkohen nga rregullat e GATT-it për kombin më të favorizuar.

SAFEGUARD--An action taken by a country to protect a domestic industry that is threatened or injured as a result of importation of goods from another country. GATT permits two forms of multilateral safeguards: (a) a country's right to impose temporary import controls or other trade restrictions to prevent commercial injury to domestic industry, and (b) the corresponding right of exporters not to be deprived arbitrarily of access to markets.

SECURITY AGREEMENT--An agreement that creates or provides for a security interest between the debtor and a secured party. An interest in real or personal property that serves as collateral (q.v.) for a debt or other obligation. Security interest is normally perfected (made enforceable against other creditors) when the creditor either takes possession of the collateral or files financial statements in the proper public records.

SERVICES--In the context of international trade policy, services may encompass banking, finance, transportation, insurance, professional services, telecommunications, health care, and education. There is, however, no generally agreed upon definition for services within the international trading community. Within the context of the General Agreement of Trade in Services, under the General Agreement on Tariffs and Trade, the services covered by the agreement are those service sectors agreed to be covered by each country in its schedule of concessions thereto.

STANDBY LETTER OF CREDIT--Type of letter of credit (q.v.) in which the issuer's payment obligation

MASE MBROJTËSE--Veprimi që ndërmerr një vend për të mbrojtur industrinë vendase që rrezikohet ose dëmtohet si pasojë e importimit të mallrave nga një vend tjetër. GATT-i lejon dy forma të mbrojtjes shumpalëshe: (a) të drejtën e një vendi të vendosë kontrolle të përkohshme mbi importet ose restriksione të tjera tregëtare për të parandaluar dëmtimin tregëtar të industrisë vendase, dhe (b) të drejtën koresponduese të eksportuesve për të mos u përjashtuar në mënyrë arbitrare nga pjesëmarrja në tregjet e huaj.

MARRËVESHJE GARANCIE--Marrëveshja që krijon ose parashikon një interes të garantuar ndërmjet debitorit dhe palës së siguruar. Një interes mbi një pasuri të patundshme ose çdo lloj pasurie tjetër që shërben si sigurim huaje (Shih: Sigurim Huaje) ose detyrimi tjetër. Një interes i garantuar bëhet normalisht i plotë (i mbrojtur nga kreditorët e tjerë) kur kreditori ose merr në posedim pasurinë siguruese ose garantuese, ose bën shënimet e duhura financiare në regjistrat përkatës publik.

SHËRBIMET--Në kontekstin e politikës së tregëtisë ndërkombëtare, shërbimet mund të përfshijnë shërbimet bankare, financiare, profesionale, ato të transportit, të sigurimit, të telekomunikacionit, të përkujdesjes shëndetësore si dhe të arësimit. Megjithatë, nuk ka ndonjë përkufizim të pranuar gjerësisht për shërbimet në komunitetin e tregëtisë ndërkombëtare. Brënda kontekstit të GATT-it, shërbimet e mbuluara nga marrëveshja janë ato sektorë shërbimesh që çdo vend ka rënë dakort t'i pranojë si të tillë.

LETËR KREDIE MBËSHTETËSE (OSE GARANTUESE)--Lloj letre kredie (Shih: Letër Kredie), në të cilën

is contingent upon its customer's (the purchaser's) default (q.v.) or failure to perform, rather than the beneficiary's performance of the underlying transaction between the customer and the beneficiary.

detyrimi i lëshuesit për të paguar varet jo aq në realizimin ose jo të transaksionit ndërmjet klientit (blerësit) dhe përfituesit, se sa në mospërmbushjen (Shih: Mospërmbushje) ose dështimin e klientit për shlyerjen e detyrimit.

SUBSIDY--A benefit given by a government to an enterprise, industry, region, or other party. GATT does not directly define subsidies, but under GATT certain types of subsidies are prohibited. The United States regards a subsidy as a bounty or grant paid for manufacture, production, or export of an article.

SUBVENCION--Mbështetja financiare, ndihma ose donacioni që i jepet një ndërmarrjeje, industrije, rajoni ose një pale tjetër nga qeveria. GATT-i nuk i përcakton drejtpërdrejt llojet e subvencioneve, por sipas GATT-it disa prej tyre ndalohen. Shtetet e Bashkuara e konsiderojnë subvencionin një lloj donacioni ose ndihme që jepet për përpunimin, prodhimin ose eksportimin e një malli.

TARIFF--A charge assessed by a government, in accordance with its tariff schedule, on goods or services (q.v.) as they enter (or leave) a country. A tariff may be imposed to protect domestic industries from imported goods or services and/or to generate revenue. Types of tariffs include ad valorem, specific, or variable tariffs, or some combination of the three. Customs Duty (q.v.); Duties.

TARIFË--Detyrimi financiar që caktohet nga qeveria, në përputhje me listat e saj të tarifave, për mallrat ose shërbimet (Shih: Shërbimet) kur këto hyjnë në (ose dalin nga) një vend. Tarifa mund të vendoset për të mbrojtur industrinë e brendshme nga importet e mallrave ose shërbimeve dhe/ose për të siguruar të ardhura. Disa lloj tarifash përfshijnë, tarifa ad valorem (sipas vlerës), tarifa të veçanta ose të ndryshme ose një kombinacion të këtyre tre llojeve. Taksë doganore (Shih: Taksë Doganore); Taksat.

TARIFF QUOTAS--The application of a higher tariff (q.v.) rate to imported goods after a specified quantity of the item has entered the country at a lower prevailing rate.

KUOTAT TARIFORE--Zbatimi i një shkallë më të lartë tarifash (Shih: Tarifë) doganore për mallrat e importuara, pasi të ketë hyrë në vend një sasi e caktuar prej tyre me një shkallë më të ulët.

TERMS OF TRADE--The economic factors affecting a country's foreign trade in goods and services, such as dependency on foreign sourcing and relative competitiveness in production.

KUSHTET E TREGËTISË--Faktorët ekonomike që ndikojnë në tregëtinë e jashtme të mallrave dhe shërbimeve të një vendi, si varësia nga burimet e huaja dhe konkurrenca relative në prodhim.

TRANSMITTAL LETTER--A list of the particulars of the shipment and a record of the documents being transmitted, together with instructions for disposition of the documents. Any special instructions are also included.

LETËR SHOQËRIMI--Lista e detajuar e ngarkesës si dhe proces-verbali i dokumentave që do të dërgohen, së bashku me udhëzimet për disponimin e dokumentave. Mund të përfshihen gjithashtu edhe udhëzime të tjera të veçanta.

TRANSPARENCY--The extent to which laws, regulations, agreements, and practices affecting international trade are open, clear, measurable, and verifiable.

TRANSPARENCA--Shkalla në bazë të së cilës mund të gjykohet se sa të hapura, të qarta, të sakta dhe të verifikueshme janë ligjet, rregulloret, marrëveshjet dhe praktikatat që ndikojnë në tregëtinë ndërkombëtare.

UNFAIR TRADE PRACTICE--Any act, policy, or practice of a country that (a) violates, is inconsistent with, or otherwise denies benefits granted to a foreign country under any trade agreement to which both countries are a party, or (b) is otherwise unjustifiable, unreasonable, or discriminatory and burdens or restricts a foreign country's commerce.

PRAKTIKA TREGËTARE TË PADREJTA--Akti, politika, ose praktika e një vendi që (a) dhunon, vjen në kundërshtim ose mohon përfitimet e akorduara një vendi tjetër në bazë të ndonjë marrëveshje tregëtare, anëtarë të së cilës janë të dy vendet, ose që (b) është gjithashtu i pajustificueshëm, i paarsyeshëm ose diskriminues dhe dëmton ose kufizon tregëtinë e vendit tjetër.

VALUATION--The act of ascertaining the worth of an imported good by government officials of the importing country so that the appropriate tariff (q.v.) or duty is paid by the importer of the good.

VLERËSIMI--Veprimtaria për të përcaktuar vlerën e një malli të importuar nga nëpunësit shtetërorë të vendit importues me qëllim që importuesi i mallit të paguajë tarifën (Shih: Tarifë) ose detyrimin e përshtatshëm.

VALUE-ADDED TAX (VAT)--An incremental tax imposed on the value of an item or service at each stage in its processing, production, and distribution.

TATIM MBI VLEREN E SHITUAR (TVSH)--Një tatim, që vjen duke u rritur, i vendosur mbi vlerën e një artikulli ose shërbimi në çdo fazë të tij të përpunimit, prodhimit dhe shpërndarjes.

VOLUNTARY RESTRAINT AGREEMENT (VRA)--Informal bilateral or multilateral understanding in which exporters voluntarily limit exports of certain products to a particular country in order to avoid economic dislocation in the importing country and the imposition by that country of mandatory import restrictions (q.v.).

MARRËVESHJE VULLNETARE PËR VETKUFIZIM--Një marrëveshje jo-zyrtare e dyanëshme ose e shumanëshme, me anën e së cilës eksportuesit kufizojnë vullnetarisht eksportet e disa produkteve të destinuara ndaj një vendi të caktuar, me qëllim që të shmangin çrregullimet ekonomike të vendit importues dhe vendosjen nga ky i fundit të kufizimeve të detyrueshme mbi importet (Shih:

WARRANTY--A promise that a proposition of fact is true. An assurance by one party to an agreement of the existence of a fact upon which the other party may rely. It is intended to relieve the promisee of any duty to ascertain facts for himself or herself and amounts to a promise to indemnify the promisee for any loss if the fact warranted proves untrue. A warranty is a promise that certain facts are truly as they are represented to be and that they will remain so, subject to any specified limitations. In certain circumstances, a warranty may be presumed, known as an "implied" warranty. A warranty is an assurance or guaranty, either expressed in the form of a statement by the seller of goods or implied by law and having reference to and ensuring the character, quality, or fitness of purpose of the goods.

GARANCIA--Premtimi se një gjëndje faktesh është e vërtetë. Siguria e një pale në një marrëveshje për qënien e një fakti mbi të cilin mund të mbështetet pala tjetër. Garancia synon të lehtësojë të premtuarin (të garantuarin) nga barra për të vërtetuar vetë ai ose ajo qënien e fakteve, si dhe është një premtim për të zhdëmtuar të premtuarin nga çdo humbje në qoftë se faktet nuk janë të vërteta. Garancia është një premtim se disa fakte janë të vërtetë ashtu siç duhet të jenë, dhe, se ato do të mbeten të tilla në varësi me disa kufizime të veçanta. Në kushte të caktuara, një garantim mund të prezumohet i njohur si një garanci "e nënkuptuar." Një garanci është një siguri ose garanci, qoftë e shprehur në formën e një deklarimi nga blerësi i mallrave ose i nënkuptuar nga ligji dhe që i referohet sigurimit të natyrës, të cilësisë ose të përmbajtjes së qëllimit të mallrave.

ALBANIAN-ENGLISH CROSS-REFERENCE INDEX

Agjent (Ndërmjetës) për Transport Mallrash--Freight Forwarder
Akt-Dorëzim i Ngarkesës--Consignment
Barrë--Encumbrance
Bilanc--Balance Sheet
Blerjet Shtetërore--Government Procurement
Çek (Urdhër-pagese)--Draft
Çek i Datuar--Date Draft
Çek Këmbyes--Draft Bill of Exchange
Çertifikata e Origjinës--Certificate of Origin
Deklarimi i të Ardhurave--Income Statement
Detyrim i Mundshëm--Contingent Liability
Dëmshpërblim (Zhdëmtim)--Indemnification
Dumping--Dumping
Faturë Tregëtare--Commercial Invoice
Financimi i Borxhit--Debt Financing
Financimi i Pasurisë--Equity Financing
Fletë Kontrolli (Çertifikatë e Inspektimit)--Certificate of Inspection
Forcë Madhore--Force Majeure
Garancia--Warranty
Garantim--Guaranty
Hapja e Tregut--Market Access
Hipotekë--Mortgage
Humbje, Zhveshje nga Pronësia--Forfeiting
Importe të Tregut Gri--Gray Market Imports
Interesi--Interest
Klauzolë Përjashtuese--Escape Clause
Kontroll i Eksportit--Export Control
Konventë--Covenant
Konventë Negative--Negative Covenant
Konventë Pozitive--Affirmative Covenant

Kosto Prodhimi--Cost of Production
 Kostua dhe Ngarkesa--Cost and Freight
 Kostua, Sigurimi dhe Ngarkesa--Cost, Insurance, and Freight
 Kufizimet e Importit--Import Restrictions
 Kufizimet Sasiore--Quantitative Restriction
 Kundërveprimi--Retaliation
 Kuotat e Importit--Import Quotas
 Kuotat Tarifore--Tariff Quotas
 Kuotë--Quota
 Kurs i Ardhshëm Këmbimi--Forward Exchange Rate
 Kurs Këmbimi--Exchange Rate
 Kusht Pararendës--Condition Precedent
 Kushtet e Tregëtisë--Terms of Trade
 Letër Kredie--Letter of Credit
 Letër Kredie e Parevokueshme--Irrevocable Letter of Credit
 Letër Kredie e Revokueshme--Revocable Letter of Credit
 Letër Kredie Konfirmuese--Confirmed Letter of Credit
 Letër Kredie Mbështetëse (ose Garantuese)--Standby Letter of Credit
 Letër Shoqërimi--Transmittal Letter
 Letër-Pranimi Bankar--Banker's Acceptance
 Liçencë Eksporti--Export License
 Liçencë Importi--Import License
 Llogari e Hapur--Open Account
 Marrëveshja Garancie--Security Agreement
 Marrëveshja për Tregëti të Lirë--Free Trade Agreement
 Marrëveshja për Tregëti të Rregullt--Orderly Marketing Agreement
 Marrëveshja Vullnetare për Vetkufizim--Voluntary Restraint Agreement
 Marrëveshja shumpalëshe--Multilateral Agreement
 Masë Mbrojtëse--Safeguard
 Mjet sigurimi i Detyrimit--Lien
 Mospërmbushje, Mosshlyerje--Default

Ndërmarrje të Përbashkëta--Joint Venture
 Normë fitimi--Rate of Return
 Notë Premtuese--Promissory Note
 Nxitja e Eksportit--Export Promotion
 Opinion Ligjor--Legal Opinion
 Paraja për Qarkullim--Cash Flow
 Pengesat Jo-Tarifore--Non-Tariff Barrier
 Pengu--Pledge
 Përbushja e Kërkesave Shtetërore--Performance Requirements
 Policë e Pastër (Faturë e Pastër e Dorëzimit të Ngarkesës)--Clean Bill of
 Lading
 Policë Ngarkesë (Faturë Ngarkese)--Bill of Lading
 Policë Ngarkesë Dëmtimi--Foul Bill of Lading
 Praktika Tregëtare të Padrejta--Unfair Trade Practice
 Raport Kredie--Credit Report
 Reciprociteti--Reciprocity
 Rregullat e Origjinës--Rules of Origin
 Rreziku--Risk
 Shërbimet--Services
 Shpronësim--Expropriation
 Sigurim Huaje--Collateral
 Sistem i Harmonizuar--Harmonized System
 Subvencion--Subsidy
 Taksa--Duty
 Taksë Doganore--Customs Duty
 Taksë Doganore e Paguar për Transport--Delivered Duty Paid
 Taksë Doganore Plotësuese--Countervailing Duty
 Tarifë--Tariff
 Tarifë e Jashtme e Përbashkët--Common External Tariff
 Tatim mbi Vlerën e Shtuar--Value-Added Tax
 Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale--Intellectual Property Rights

Trajtim Kombëtar--National Treatment

Trajtimi i Kombit më të Favorizuar--Most Favored Nation Treatment

Traktat Bilateral Investimesh--Bilateral Investment Treaty

Transparenca--Transparency

Transportim Falas--Free on Board

Transportim Falas deri tek Anija--Free Alongside Ship

Tregëti me Klering (Tregëti mall me mall)--Countertrade

Veprimtari në Qendrën Tregëtare--Factoring

Vijë Kredie--Line of Credit

Vlerësimi--Valuation

Zonë e Tregëtisë së Lirë--Free Trade Zones